



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Gjiçanit
Opština Gnjilane
Municipal Gjiçan
Gilan Belediyesi

Në bazë të nenit 11 paragrafi 1, nenit 18 paragrafi 1 dhe 3 të Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës nr. 04/L-149 dhe nenit 11 të Ligjit për Bibliotekat, nr. 04/L-097, Komuna e Gjiçanit shpall;

KONKURS PUBLIK

Për plotësimin e pozitës punuese

Zyra e Kryetarit

Njësia për Kulturë, Rini dhe Sport

Titulli i punës: Drejtor i Bibliotekës të Qytetit

Lloji i pozitës: E mandatar

Koeficienti: 8

Kategoria funksionale: Niveli drejtues

Orari i punës: 40 orë në javë

Nr. i ref. JP00019222

Qëllimi i vendit të punës: Menaxhimi dhe Promovimi i Bibliotekës:

Detyrat dhe përgjegjësitë :

- Drejtori i bibliotekës udhëheq, organizon dhe mbikëqyrë veprimtarinë dhe funksionimin e bibliotekës amë dhe degët e saja;
- I propozon Këshillit drejtues të bibliotekës planin vjetor dhe financiar të punës;
- Për punën e tij i raporton dhe i përgjigjet Këshillit Drejtues;
- përfaqëson bibliotekën brenda dhe jashtë vendit;
- Merr pjesë në mbledhjen e Këshillit Drejtues pa të drejtë vote;
- Bashkëpunon me bibliotekat vendore dhe jashtë vendit;
- Koordinin debate, trajnime, seminare dhe panairë për biblioteka në regjion;
- Ushtron detyra dhe autorizime tjera në përputhje me legjislacionin në fuqi;

Kualifikimi dhe shkathtësitë e kërkuara:

- Diplomë universiteti nga fusha e Bibliotekarisë ose lëmi të përafërta;
- Të ketë 4 vite përvojë pune profesionale në nivele drejtuese;
- Të ketë njohuri të punës me kompjuter, Word, Excel;
- Të ketë shkathësi të mira menaxhuese, komunikuese dhe ndër njerëzore ;
- Të ketë aftësi të mira për ruajtjen dhe zhvillimin e kontakteve brenda dhe jashtë Bibliotekës.

Rregullimi i mandatit: bazuar në nenin 11 paragrafi 2 të Ligjit për Bibliotekat nr. 04/L-097, mandati i Drejtorit të Bibliotekës të Qytetit është 4 (katër) vite me mundësi rizgjedhjeje.

Çdo kandidat (aplikues) për pozitën e lartcekur duhet t'i komplotoj dhe dorëzoj dokumentacionin e domosdoshëm (foto kopje) si vijon :

1. dëshmi të kualifikimit shkollorë në fotokopje e nëse kandidati e ka kryer shkollimin jashtë Republikës së Kosovës diploma duhet të jetë e nostrifikuar në MASHT.
2. dëshmi mbi përvojën e punës dhe trajnimet e kryera
3. dokumentin e identifikimit;
4. certifikata që nuk është nën hetime dhe i denuar

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar dhe i plotësojnë kushtet në aspektin e kualifikimit dhe shkathësisve të kërkuara me konkurs

Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës dhe i mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë. Komunitetet jo shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë drejtë përfaqësim proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike si në nivel qendror njashu edhe atë lokal

Aplikacionet merren dhe të plotësuara dorëzohen në arkivin qendror të Komunës së Gjilanit, përkatësisht në Qendrën për Shërbim të Qytetarëve

Afati i aplikimit është 15 ditë, nga dita e shpalljes publike të konkursit në mjetet e informimit publik, Web faqen komunale dhe tabelën e shpalljeve publike, edhe atë nga data 20.01.2017 deri më datë 03.02.2017

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen, kurse ato të mangëta refuzohen.

Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e shkurtër do të kontaktohen përmes tel ose emailit të cilin duhet shënuar në aplikacion.